



REPUBLIKA E KOSOVËS - PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO - THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - PRESEDNIK

STATUTI
I
KËSHILLIT KONSULTATIV PËR KOMUNITETE

Prishtinë, 06 dhjetor 2017



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – PRESEDNIK

Presidenti i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 84 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6 të Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës (GZ, nr. 47, 25 janar 2009), nenit 12 (2) të Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës (GZ, nr. 28, 4 qershor 2008), i ndryshuar dhe plotësuar me nenin 15 të Ligjit nr. 04/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës (GZ, nr. 25, 7 shtator 2012) dhe Ligjin nr. 04/L-020 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës (GZ, nr. 29, 27 dhjetor 2011), si dhe nenin 3 (4) të Rregullores (P) nr. 02/2016 për strukturën organizative të Presidencës (08.09.2016), nxjerr:

STATUTIN E KËSHILLIT KONSULTATIV PËR KOMUNITETE

KAPITULLI I - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Me këtë statut përcaktohet organizimi, funksionimi dhe përgjegjësitë e Këshillit Konsultativ për Komunitete.

Neni 2
Fushëveprimi

Statuti zbatohet nga Këshilli, Sekretariati, njësitë përkatëse të Presidencës, organizatat përfaqësuese të Komunitetit dhe të gjithë personat e tjerë që marrin pjesë në punën e Këshillit.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë statut kanë këtë kuptim:
 - 1.1 **Kushtetutë** – Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
 - 1.2 **President** – Presidenti i Republikës së Kosovës;
 - 1.3 **Kuvendi** – Kuvendi i Republikës së Kosovës;
 - 1.4 **Presidencë** – Përfshin Kabinetin e Presidentit, Zyrën e Presidentit dhe institucionet/njësitet e tjera të ndërlidhura;
 - 1.5 **Zyrë** – Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës;
 - 1.6 **Qeveri** – Qeveria e Republikës së Kosovës;
 - 1.7 **Këshill** – Këshilli Konsultativ për Komunitete;
 - 1.8 **Sekretar** – Sekretari i Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës;
 - 1.9 **Sekretari i Këshillit** – Udhëheqësi i Sekretariatit të Këshillit;
 - 1.10 **Sekretariat** – Sekretariati i Këshillit Konsultativ për Komunitete;
 - 1.11 **Departament** – Departamenti për Çështje Juridike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare në kuadër të Zyrës së Presidentit;
 - 1.12 **Kandidat i nominuar** – secili person i propozuar nga një organizatë përfaqësuese e Komunitetit, apo secili person i cili kandidon në mënyrë individuale dhe i cili ka marrë mbështetjen në seancën e nominimit për t’u emëruar anëtar në Këshill;
 - 1.13 **Organizatë përfaqësuese e Komunitetit** – nënkupton çdo organizatë joqeveritare, e cila është e themeluar dhe e regjistruar në përputhje me ligjin përkatës, dhe e cila deklaron se e përfaqëson një komunitet të caktuar;
 - 1.14 **Seancë e nominimit** – nënkupton takimin në të cilin marrin pjesë organizatat përfaqësuese të një komuniteti, të cilat i kanë përmbushur kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë statut, dhe të cilat i nominojnë kandidatët për emërim në Këshill;
 - 1.15 **Ligj** – nënkupton Ligjin nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 28, 4 qershor 2008), neni 15 i Ligjit nr. 04/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 25, 7 shtator 2012) dhe Ligji nr. 04/L-020 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 29, 27 dhjetor 2011).
2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë statut kanë kuptimin e njëjtë si në përkufizimet e Kushtetutës apo të Ligjit.

KAPITULLI II - STATUSI DHE MANDATI I KËSHILLIT

Neni 4 Statusi i Këshillit

Këshilli vepron nën autoritetin e Presidentit, në të cilin përfaqësohen të gjitha komunitetet.

Neni 5 Pavarësia e Këshillit

1. Këshilli, në pajtim me mandatin e tij, është i pavarur dhe vepron në emër të vet gjatë miratimit të vendimeve, rekomandimeve apo kur ndërmerr ndonjë veprim.
2. Vendimet, rekomandimet dhe veprimet e Këshillit nuk do t'i atribuohen Presidentit.
3. Kryesuesi, zëvendëskryesuesit dhe anëtarët e Këshillit mbajnë bashkëpërgjegjësinë për vendimet, rekomandimet dhe veprimet që ndërmerr Këshilli, si dhe përgjegjësinë individuale për veprimet e tyre.

Neni 6 Mandati i Këshillit

1. Mandati i Këshillit, siç është përcaktuar me nenin 60 (3) të Kushtetutës, përfshin:
 - 1.1. Ofrimin e një mekanizmi për shkëmbimin e rregullt ndërmjet komuniteteve dhe Qeverisë;
 - 1.2. mundësinë e komuniteteve për të komentuar në një fazë të hershme nismat legislative dhe politike, të cilat mund të përgatiten nga Qeveria, për të sugjeruar nisma të tilla dhe për të kërkuar që pikëpamjet e tyre të përfshihen në projektet dhe programet përkatëse.
 - 1.3. çdo përgjegjësi a funksion tjetër, në pajtim me Ligjin.
2. Këshilli gjithashtu ka mandat të përcaktuar me nenin 12 (1) të Ligjit, që përfshin:
 - 2.1. të ndihmojë në organizimin dhe në artikullimin e pikëpamjeve të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në lidhje me legjislacionin, politikat dhe programet publike që kanë rëndësi të veçantë për to;
 - 2.2. të ofrojë një forum për konsultim dhe bashkërendim ndërmjet komuniteteve dhe të sigurojë funksionimin efikas të organizatave përfaqësuese të komuniteteve, në përputhje me Kodin e Mirësjelljes, që do të miratohet nga Këshilli;
 - 2.3. të ofrojë një mekanizëm për shkëmbim të rregullt ndërmjet komuniteteve dhe institucioneve shtetërore;
 - 2.4. t'ua ofrojë mundësinë komuniteteve që në faza të hershme të marrin pjesë në nismat ligjore apo të politikave, të cilat mund të përgatiten nga Qeveria ose Kuvendi, të sugjerojnë nisma të tilla dhe që mendimi i tyre të inkorporohet në projekte dhe programe përkatëse, përfshirë Strategjinë gjithëpërfshirëse për promovimin dhe

- mbrojtjen e të drejtave të të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre dhe raportin vjetor gjithëpërfshirës që Qeveria ia paraqet Kuvendit për zbatimin e strategjisë së saj, në pajtim me Ligjin;
- 2.5. të plotësojë kërkesën për konsultime të tjera të detyrueshme në relacion me akte të caktuara ligjore që janë paraparë në Kushtetutë dhe me Ligj;
 - 2.6. t'u mundësojë komuniteteve që të marrin pjesë në vlerësimin e nevojave, hartimin, monitorimin dhe vlerësimin e programeve që u kushtohen pjesëtarëve të tyre, apo që kanë rëndësi të posaçme për ta;
 - 2.7. të japë rekomandime gjatë procesit të vendimmarrjes në lidhje me caktimin e fondeve, qofshin ato ndërkombëtare, apo të ndara nga Buxheti i Republikës së Kosovës, për projekte që u dedikohen komuniteteve apo interesave të tyre të veçanta;
 - 2.8. të kontribuojë në raportimin e Qeverisë që u drejtohet mekanizmave ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut, dhe
 - 2.9. të rritë vetëdijen për brengat e komuniteteve brenda Republikës së Kosovës dhe të kontribuojë në marrëdhëniet e harmonishme ndërmjet të gjitha komuniteteve në Republikën e Kosovës.

KAPITULLI III - KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E KËSHILLIT

Neni 7

Shkëmbimi i informacioneve me Qeverinë dhe institucionet e tjera

1. Këshilli shkëmben informacione me organet përkatëse të Qeverisë dhe institucionet tjera dhe jep rekomandime lidhur me komunitetet në Kosovë me qëllim që të nxisë, të mbështesë dhe të promovojë barazi të plotë dhe efektive të pjesëtarëve të komuniteteve në të gjitha fushat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore dhe pjesëmarrjen efektive të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në jetën publike dhe në vendimmarrje, duke ndërmarrë, por duke mos u kufizuar në masat, si në vijim:
 - 1.1. ndihmon në organizimin dhe në artikulumin e pikëpamjeve të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në lidhje me legjislacionin, politikën dhe programet publike që kanë rëndësi të veçantë për to;
 - 1.2. u mundëson komuniteteve që të marrin pjesë në vlerësimin e nevojave, hartimin, monitorimin dhe vlerësimin e programeve dhe strategjive që u kushtohen pjesëtarëve të tyre, apo që kanë rëndësi të posaçme për ta;
 - 1.3. rekomandon gjatë procesit të vendimmarrjes në lidhje me caktimin e fondeve, qofshin ato ndërkombëtare, apo të ndara nga Buxheti i Republikës së Kosovës, për projekte që u dedikohen komuniteteve, apo interesave të tyre të veçanta;
 - 1.4. kontribuon në raportimin e Qeverisë që u drejtohet mekanizmave ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut; ngre vetëdijen për brengat e komuniteteve brenda Republikës

- së Kosovës dhe kontribuon në marrëdhëniet harmonike ndërmjet të gjitha komuniteteve në Republikën e Kosovës, si dhe
- 1.5. bashkëpunon me Qeverinë në organizimin e ditëve memoriale të komuniteteve.

Neni 8

Përfshirja në nismat legislative dhe të politikave

1. Këshilli ua ofron mundësinë komuniteteve që në faza të hershme t'i komentojnë nismat ligjore apo të politikave, të cilat mund të përgatiten nga Qeveria ose Kuvendi, si dhe të sugjerojë nisma të tilla.
2. Sekretariati në fillim të çdo viti, në bashkëpunim me zyrat përkatëse në Qeveri dhe Kuvend, përkujdeset për sigurimin e Programit Legjislativ dhe Planit të Dokumenteve Strategjike, të miratuar nga Qeveria dhe Programi i Punës së Kuvendit.
3. Sekretariati bashkëpunon me institucionet qeveritare dhe me Kuvendin gjatë shqyrtimit të nismave legislative për ta informuar dhe për t'i ofruar mundësinë Këshillit për dhënie të komenteve në fazën nismëtare të hartimit, si dhe në fazën e shqyrtimit të projektligjit nga komisioni përkatës i Kuvendit dhe të parashtrijë komente apo vërejtje përmbajtjesore me shkrim.

Neni 9

Pjesëmarrja në hartimin e Strategjisë gjithëpërfshirëse për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të të gjitha komuniteteve

1. Në përputhje me Ligjin, Këshilli konsultohet në fazën e hershme për hartimin e Strategjisë gjithëpërfshirëse vjetore të Qeverisë për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.
2. Këshilli bashkëpunon me Qeverinë dhe bën komente në propozim-raportin vjetor qeveritar për zbatimin e strategjisë para se t'i dorëzohet Kuvendit.
3. Këshilli, në bashkëpunim me institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës dhe organizatat përfaqësuese të Komunitetit, merr pjesë në zhvillimin e Strategjisë për mbrojtjen efektive të monumenteve të trashëgimisë kulturore dhe fetare të komuniteteve.

Neni 10

Rekomandimet e Këshillit

1. Këshilli jep rekomandime në bazë të mandatit të tij.
2. Këshilli duhet të sigurohet që rekomandimet e tij janë sjellë në vëmendjen e institucioneve publike përkatëse të Republikës së Kosovës.
3. Institucionet publike përkatëse që nga pranimi i rekomandimeve nga Këshilli janë të obliguara të ofrojnë një përgjigje të arsyeshme në afat prej një (1) muaji, të cilat përfshijnë informata rreth veprimeve të institucioneve specifike që janë ndërmarrë apo që do të ndërmerren.

KAPITULLI IV - ORGANIZIMI I KËSHILLIT

Neni 11

Përbërja e Këshillit

1. Presidenti emëron anëtarët e Këshillit në pajtim me Ligjin.
2. Këshilli përbëhet nga njëzeteshtatë (27) anëtar.
3. Këshilli përbëhet nga përfaqësues të të gjitha komuniteteve të Kosovës dhe përfaqësues të Qeverisë, Zyrës dhe agjencive të tjera relevante, siç është përcaktuar me nenin 12 (6) të Ligjit, që përfshin:
 - 3.1. nga dy (2) përfaqësues të komunitetit rom, egjiptian, goran, ashkali, malazez dhe kroat, prej të cilëve nga një (1) mund të jetë deputet i Kuvendit;
 - 3.2. nga tre (3) përfaqësues të komunitetit boshnjak dhe turk, prej të cilëve nga një (1) mund të jetë deputet i Kuvendit;
 - 3.3. pesë (5) përfaqësues të komunitetit serb, prej të cilëve dy (2) mund të jenë deputetë të Kuvendit;
 - 3.4. një (1) përfaqësues i lartë i Zyrës;
 - 3.5. tre (3) përfaqësues të lartë të Qeverisë, që caktohen nga ministria apo agjencia, fushëveprimi i të cilëve është me rëndësi të veçantë për komunitetet.
4. Për secilin anëtar mund të emërohet një (1) zëvendës anëtar.
5. Anëtarët të cilët nuk janë deputetë të Kuvendit, janë zakonisht kryesues apo zëvendëskryesues, apo të emëruar të tjerë të lartë të organizatave përfaqësuese të komuniteteve, apo përfaqësues të shoqatave ose OJQ-ve, që kanë të bëjnë me komunitetin e caktuar.

Neni 12

Kryesimi i Këshillit

1. Këshilli e zgjedh nga radhët e tij kryesuesin dhe dy (2) zëvendëskryesues me mandat një (1) vjeçar, me mundësi vazhdimi edhe për një vit.
2. Së paku njëri nga anëtarët e Kryesisë së Këshillit duhet të jetë i gjinisë tjetër.

Neni 13

Kryesuesi i Këshillit

1. Kryesuesi i Këshillit i ka këto kompetenca:
 - 1.1. thërret dhe kryeson takimet e Këshillit;
 - 1.2. organizon dhe kujdeset për mbarëvajtjen e punës së përgjithshme të Këshillit;
 - 1.3. siguron zbatimin e këtij statuti dhe legjislacionit përkatës në fuqi;
 - 1.4. përfaqëson Këshillin në kontakt me publikun;
 - 1.5. informon anëtarët e Këshillit për punën dhe aktivitetet e tij;
 - 1.6. kryen dhe ndërmerr veprime në të mirë të punës së Këshillit;
 - 1.7. kryen detyra të tjera, të cilat ia beson Këshilli.

Neni 14

Zëvendëskryesuesit e Këshillit

1. Kryesuesi ndihmohet nga dy (2) zëvendëskryesues.
2. Dy (2) zëvendëskryesuesit zgjidhen nga dy (2) komunitete, të cilave nuk u përket kryesuesi.
3. Zëvendëskryesuesi i cili merr vota më së shumti nga anëtarët e Këshillit zgjidhet zëvendëskryesues i parë.
4. Zëvendëskryesuesit e ndihmojnë kryesuesin në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të tij.
5. Zëvendëskryesuesi i parë e zëvendëson kryesuesin në mungesë të tij dhe në rast të mungesës së kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit të parë zëvendësohet nga zëvendëskryesuesi i dytë.

Neni 15

Anëtarët e Këshillit

1. Anëtarët e Këshillit zbatojnë detyrat dhe përgjegjësitë në përputhje me mandatin e Këshillit.
2. Anëtarët e Këshillit marrin pjesë në takimet e Këshillit dhe në shqyrtimin e çështjeve në pajtim me këtë statut dhe me legjislacionin në fuqi.
3. Anëtarët e Këshillit kanë të drejtë të informohen nga kryesuesi i Këshillit për veprimtarinë e Këshillit.

Neni 16

Grupet punuese të Këshillit

1. Këshilli mund të formojë grupe punuese, të cilat përbëhen më së shumti deri në pesë (5) anëtarë, me qëllim të avancimit të punës për çështje konkrete, apo për fusha specifike të Këshillit.
2. Këshilli do t' i zgjedhë anëtarët e grupeve punuese nga specialistë të fushave të veçanta për të punuar në çështjen specifike për të cilën një grup punues është themeluar.
3. Grupet punuese raportojnë në takime të rregullta të Këshillit për zbatimin e mandatit dhe aktiviteteteve të tyre dhe dorëzojnë raporte dhe rekomandime për miratim në Këshill.
4. Grupet punuese të Këshillit e pasqyrojnë përbërjen gjinore dhe atë të komuniteteve.

KAPITULLI V - TAKIMET E KËSHILLIT

Neni 17

Takimet e Këshillit që kryesohen nga Presidenti

1. Këshilli takohet dy (2) herë në vit, nën kryesimin e Presidentit, për ta bërë një shqyrtim të përgjithshëm të politikave dhe shqetësimeve të komuniteteve në Republikën e Kosovës.
2. Sekretariati, në bashkëpunim me Kabinetin e Presidentit dhe me Këshillin, bën organizimin e takimeve që kryesohen nga Presidenti.
3. Ftesa dhe agjenda e takimit që kryesohet nga Presidenti shpërndahen së paku tri (3) ditë para mbajtjes së takimit, përveç në rastet e veçanta kur vendos Presidenti.

Neni 18

Takimet e rregullta të Këshillit

1. Këshilli takohet një (1) herë në muaj.
2. Takimet e Këshillit i thërret dhe i udhëheq kryesuesi i Këshillit, në mungesë të tij ndonjëri nga zëvendëskryesuesit e tij.
3. Në takimet e Këshillit ftohen të gjithë anëtarët e tij.
4. Të gjithë anëtarët e Këshillit kanë të drejtë të barabartë vote.
5. Kryesuesi i Këshillit mund të ftojë edhe organizata të shoqërisë civile, ekspertë individualë, përfaqësues shtesë qeveritarë, ose përfaqësues të agjencive ndërkombëtare, të marrin pjesë në takimet e Këshillit, por pa të drejtë vote.
6. Në takimet e Këshillit, me ftesë të kryesuesit të Këshillit, apo sipas kërkesave të tyre, të miratuara nga kryesuesi i Këshillit, mund të marrin pjesë edhe ministrat apo zëvendësministrat e ministrive dhe përfaqësuesit e agjencive shtetërore, fushëveprimi i të cilëve është me rëndësi të veçantë për komunitetet.
7. Rezultatet e takimeve të Këshillit bëhen publike.

Neni 19

Kuorumi i Këshillit

1. Këshilli ka kuorum për mbajtjen e takimeve kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të tij.
2. Këshilli merr vendime me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë, me përjashtim të rasteve të përcaktuara me këtë statut.

Neni 20

Parandalimi i konfliktit të interesit

Kryesuesi, zëvendëskryesuesit dhe cilido anëtar i Këshillit nuk merr pjesë në shqyrtimin e ndonjë çështjeje për të cilën ai ka konflikt interesi, në pajtim me legjislacionin në fuqi për konfliktin e interesave.

KAPITULLI VI - SEKRETARIATI I KËSHILLIT KONSULTATIV PËR KOMUNITETE

Neni 21

Sekretariati i Këshillit Konsultativ për Komunitete

1. Këshilli Konsultativ për Komunitete mbështetet nga Sekretariati, i vendosur në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës.
2. Sekretariati udhëhiqet nga sekretari i Këshillit, i cili i përgjigjet dhe raporton drejtpërdrejt Presidentit për fushën që mbulon ky Sekretariat, ndërsa për çështje administrative i përgjigjet sekretarit të Zyrës së Presidentit.
3. Sekretari i Këshillit dhe të punësuarit e tjerë në Sekretariat përzgjidhen, emërohen dhe shkarkohen në pajtim me dispozitat ligjore për nëpunësit civilë.
4. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretariatit janë, si në vijim:
 - 4.1. mbështet dhe promovon aktivitetet e Këshillit;
 - 4.2. mbështet Këshillin dhe grupet punuese të tij, duke përfshirë organizimin e takimeve, përgatitjen e rendit të ditës dhe mbajtjen e procesverbaleve nga takimet e tyre;
 - 4.3. ndihmon që Këshilli t'i përmbushë detyrimet e tij sipas Ligjit, sipas këtij statuti dhe sipas legjislacionit përkatës në fuqi;
 - 4.4. është përgjegjës për të planifikuar dhe për të menaxhuar me buxhetin e Këshillit;
 - 4.5. ndihmon Këshillin në dhënien e mendimeve për projekt-legjislacionin dhe projekt-dokumentet e politikave të përgatitura nga Qeveria dhe Kuvendi. Për realizimin e kësaj pike, Sekretariati bashkëpunon edhe me Departamentin;
 - 4.6. pranon dhe dërgon të gjitha shkresat dhe komunikimet tjera zyrtare për të gjithë anëtarët e Këshillit;
 - 4.7. bën publikime për aktivitetet e Këshillit, kryen punët e informimit publik, si dhe përgjigjet në kërkesa për informata lidhur me punën e Këshillit;
 - 4.8. përfaqëson Presidencën në zbatimin e procedurave të nominimit, të përfshira në Ligj dhe në këtë statut;
 - 4.9. angazhohet në zhvillimin e studimeve dhe hulumtimeve për çështjen e komuniteteve dhe sipas nevojës, kërkon këshilla nga ekspertë të jashtëm;
 - 4.10. mbështet kryerjen e çfarëdo funksioni tjetër të Këshillit në pajtim me Ligjin, me këtë statut dhe me legjislacionin përkatës në fuqi.
5. Sekretariatit do t'i ndahet buxheti që do t'i mundësojë funksionim efikas dhe, midis tjerash, angazhim në zhvillimin e studimeve dhe hulumtimeve, të kërkojë këshilla nga ekspertë të jashtëm, t'i rrisë kapacitetet e anëtarëve të Këshillit dhe të punësuarve në Sekretariat, si dhe t'i publikojë aktivitetet e veta.

KAPITULLI VII - PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE NOMINIMIT PËR ANËTARË TË KËSHILLIT

Neni 22

Procedura e aplikimit

1. Nëntëdhjetë (90) ditë para përfundimit të mandatit të anëtarëve të Këshillit, Sekretariati lëshon njoftimin publik me të cilin ftohen organizatat përfaqësuese të komuniteteve ta paraqesin kërkesën për aplikim, listën e kandidatëve për anëtarë të Këshillit dhe listën e delegatëve me të drejtë vote. Në këtë njoftim publik ftohen edhe kandidatët që kandidojnë në mënyrë individuale.
2. Me qëllim të inkurajimit të aplikimeve, Sekretariati nëpërmjet shpalljes publike në mjetet e informimit publik në gjuhët zyrtare dhe të komuniteteve mbledh aplikacione nga organizatat përfaqësuese të të gjitha komuniteteve dhe kandidatëve që kandidojnë në mënyrë individuale.
3. Pjesë e njoftimit publik janë:
 - 3.1. kërkesa për aplikim të organizatës përfaqësuese të komunitetit;
 - 3.2. kërkesa për aplikim të kandidatit të organizatës përfaqësuese të komunitetit;
 - 3.3. informata për kriteret që duhet t'i përmbushin organizatat përfaqësuese të komunitetit dhe kandidatët për anëtarë të Këshillit.
 - 3.4. kërkesa për kandidatët që kandidojnë në mënyrë individuale.
4. Brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e njoftimit publik, organizatat përfaqësuese të komunitetit përkatës mund të aplikojnë për Këshill dhe duhet t'i bashkëngjisin këto dokumente:
 - 4.1. kërkesën e plotësuar për aplikim;
 - 4.2. certifikatën e regjistrimit dhe statutin e organizatës përfaqësuese të komunitetit përkatës;
 - 4.3. listën e aktiviteteve të organizatës përfaqësuese të komunitetit përkatës;
 - 4.4. deklaratën e cila tregon për reputacionin dhe marrëdhënien e mirë me komunitetin që kërkon ta përfaqësojë;
 - 4.5. deklaratën për mospërfshirjen në aktivitete të prishjes së marrëdhënieve ndëretnike në Republikën e Kosovës;
 - 4.6. deklaratën për respektimin e Kodit të Mirësjelljes;
 - 4.7. listën e kandidatëve për anëtarë të Këshillit, e cila duhet të përfshijë:
 - 4.7.1. CV-në e kandidatit;
 - 4.7.2. kopjen e dokumentit të identifikimit të Republikës së Kosovës;
 - 4.7.3. listën e prioriteteve në rast të zgjedhjes së kandidatit si përfaqësues i komunitetit përkatës në Këshill;
 - 4.7.4. dëshminë nga gjykata se kandidati nuk është i dënuar për vepër penale.
 - 4.8. listën e delegatëve që marrin pjesë dhe votojnë në zgjedhjen e kandidatëve të komunitetit përkatës.
5. Brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e njoftimit publik, kandidatët që kandidojnë në mënyrë individuale mund të aplikojnë për Këshill dhe duhet t'i bashkëngjisin këto dokumente:

- 5.1. kërkesën e plotësuar për aplikim;
- 5.2. deklaratën e cila tregon për reputacionin dhe marrëdhënien e mirë me komunitetin që kërkon të përfaqësojë;
- 5.3. deklaratën për mospërfshirjen në aktivitete të prishjes së marrëdhënieve ndëretnike në Republikën e Kosovës;
- 5.4. deklaratën për respektimin e Kodit të Mirësjelljes;
- 5.5. CV-në e kandidatit;
- 5.6. kopjen e dokumentit të identifikimit të Republikës së Kosovës;
- 5.7. listën e prioriteteve në rast të zgjedhjes së kandidatit si përfaqësues i komunitetit përkatës në Këshill;
- 5.8. dëshmi nga gjykata se kandidati nuk është i dënuar për veprë penale.

Neni 23

Kriteret e përshtatshmërisë për anëtarë të Këshillit

1. Një person nuk mund të jetë anëtar i Këshillit, nëse ai/ajo:
 - 1.1. nuk është mbi tetëmbëdhjetë (18) vjeç në ditën e seancës së nominimit;
 - 1.2. nuk është i regjistruar si shtetas/e i/e Republikës së Kosovës;
 - 1.3. është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për një veprë penale të dënueshme me burgim prej gjashtë (6) muajve ose më shumë, ose për çfarëdo krimi që lidhet me gjuhën e urrejtjes, diskriminimit, jotolerancës apo motivimin e dhunës etnike, pavarësisht kohëzgjatjes së dënimit të tillë.
2. Një person nuk mund të jetë anëtar i Këshillit në qoftë se ai ka qenë dy (2) mandate anëtar i Këshillit.

Neni 24

Listat e kandidatëve dhe delegatëve

1. Lista e kandidatëve dhe lista e delegatëve që do të votojnë duhet t'i përmbajnë të dhënat e mëposhtme:
 - 1.1. lista e kandidatëve për anëtarë të Këshillit duhet t'i përmbajë së paku dy (2) kandidatë, nga të cilët pesëdhjetë (50) për qind e kandidatëve duhet të jenë meshkuj dhe pesëdhjetë (50) për qind duhet të jenë femra.
 - 1.2. në rast se komuniteti ka numër tek të vendeve në Këshill, asnjëra nga të dyja gjinitë nuk do ta kenë një përfaqësim më të ulët se dyzet (40) për qind, ose më shumë se gjashtëdhjetë (60) për qind në listën e kandidatëve.
 - 1.3. lista e delegatëve që do të votojnë nga secila organizatë përfaqësuese e komunitetit që aplikon duhet t'i përmbajë dy (2) persona.

Neni 25

Kompletimi dhe dorëzimi i dokumenteve për aplikim

1. Sekretariati i udhëzon organizatat përfaqësuese të komuniteteve dhe kandidatët që kandidojnë në mënyrë individuale lidhur me kompletimin dhe dorëzimin e kërkesave për aplikim.
2. Sekretariati i pranon dokumentet për aplikim nga organizatat përfaqësuese të komuniteteve dhe nga kandidatët që kandidojnë në mënyrë individuale.

Neni 26

Shqyrtimi i kërkesave të aplikimit

1. Sekretariati i shqyrton kërkesat e aplikimit të organizatave përfaqësuese të komuniteteve dhe të kandidatëve që kandidojnë në mënyrë individuale.
2. Në rast se kërkesa për aplikim është e pakompletuar, Sekretariati e informon organizatën përfaqësuese të komunitetit dhe kandidatët që kandidojnë në mënyrë individuale brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e aplikimit për dokumentet që i mungojnë dhe të njëjtat duhet të plotësohen brenda shtatë (7) ditëve nga dita kur është njoftuar për mungesën e dokumentacionit të duhur.
3. Organizata përfaqësuese e komunitetit apo kandidati që kandidon në mënyrë individuale, i cili apo e cila nuk e ka dorëzuar dokumentacionin në pajtim me këtë statut, nuk do të mund të marrë pjesë në seancën e nominimit.
4. Sekretariati, në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, i informon organizatat përfaqësuese të komunitetit dhe kandidatët që kandidojnë në mënyrë individuale për përmbushjen e kërkesave për aplikim brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendarike nga dita në të cilën afati i fundit për aplikim ka përfunduar.

Neni 27

Organizimi i seancës së nominimit

1. Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e përmbushjes së kërkesave për aplikim nga organizatat përfaqësuese të komunitetit përkatës dhe kandidatët që kandidojnë në mënyrë individuale, Sekretariati e organizon mbajtjen e seancës së nominimit.
2. Sekretariati i njofton me shkrim organizatat përfaqësuese të komunitetit përkatës dhe kandidatët që kandidojnë në mënyrë individuale për datën dhe vendin e mbajtjes së seancës së nominimit së paku pesë (5) ditë para se ajo të mbahet.
3. Njoftimi për organizatat përfaqësuese të komunitetit dhe kandidatët që kandidojnë në mënyrë individuale lidhur me seancën e nominimit përmban:
 - 3.1. datën dhe vendin e seancës së nominimit;
 - 3.2. listën e organizatave përfaqësuese të komunitetit që do të marrin pjesë në nominimin e përfaqësuesve të komunitetit përkatës në Këshill;
 - 3.3. listën e kandidatëve të propozuar për anëtarë të Këshillit dhe të delegatëve që do të votojnë në seancën e nominimit.

Neni 28

Komisioni Zgjedhor

1. Delegatët e organizatave përfaqësuese të komunitetit përkatës e zgjedhin nga radhët e tyre Komisionin Zgjedhor prej tre (3) anëtarëve për ta siguruar rregullsinë e procesit të votimit gjatë seancës së nominimit.
2. Anëtarët e Komisionit Zgjedhor nga radhët e tyre e zgjedhin kryetarin e Komisionit Zgjedhor.
3. Në seancën e nominimit, Komisioni Zgjedhor siguron rregullsinë e procesit të votimit, si në vijim:
 - 3.1. Komisioni Zgjedhor e shpërndan nga një fletëvotim për çdo delegat që voton;
 - 3.2. fletëvotimi duhet t'i përmbajë emrat e secilit kandidat nga lista përfundimtare e kandidatëve;
 - 3.3. delegatët duhet të votojnë për numrin e kandidatëve që korrespondon me numrin e përgjithshëm të përfaqësuesve të komunitetit që përfaqësohet në Këshill;
 - 3.4. Komisioni Zgjedhor i shpall të pavlefshme votat, nëse delegati voton më shumë sesa numri i përfaqësuesve të komunitetit në Këshill;
 - 3.5. delegati gjatë votimit do ta vendosë fletën e votimit në një kuti të mbyllur;
 - 3.6. pas kryerjes së votimit, Komisioni Zgjedhor do ta hapë kutinë, do t'i numërojë votat që i janë dhënë secilit kandidat dhe do t'i shpallë rezultatet.

Neni 29

Shpallja e rezultateve

1. Komisioni Zgjedhor i shpall rezultatet dhe ua komunikon delegatëve të pranishëm.
2. Komisioni Zgjedhor e përgatit raportin për procesin e votimit dhe rezultatin e votimit dhe ia dorëzon Sekretariatit, organizatave përfaqësuese të komuniteteve, kandidatëve që kandidojnë në mënyrë individuale dhe nëpërmjet Sekretariatit, edhe Kabinetit të Presidentit.
3. Raporti i Komisionit Zgjedhor përmban, por nuk kufizohet në të dhënat, si në vijim:
 - 3.1. listën me emrat e kandidatëve për anëtarë të Këshillit;
 - 3.2. listën e organizatave përfaqësuese të komuniteteve, të delegatëve që kanë votuar, si dhe të vëzhgueseve që kanë marrë pjesë në seancë;
 - 3.3. listën me rezultatin përfundimtar, me renditje sipas votave të fituara për secilin kandidat.
4. Duke u bazuar në raportin e Komisionit Zgjedhor, sekretari i Këshillit ia propozon Presidentit listën me rezultatin përfundimtar, me renditje sipas votave të fituara për secilin kandidat.

KAPITULLI VIII - ANKESAT NË PROCESIN E APLIKIMIT DHE NOMINIMIT PËR ANËTAR TË KËSHILLIT

Neni 30

E drejta e ankesës

1. Organizatat përfaqësuese të komunitetit dhe kandidatët që kandidojnë në mënyrë individuale kanë të drejtë ankesë në lidhje me refuzimin për mospjesëmarrje në seancën e nominimit dhe në lidhje me procesin zgjedhor.
2. Ankesat në lidhje me mospjesëmarrjen në seancën e nominimit dhe ankesat në lidhje me procesin zgjedhor në seancën e nominimit drejtohen në Presidencë brenda dyzetetë (48) orëve nga marrja e njoftimit nga Sekretariati, respektivisht nga shpallja e rezultateve nga Komisioni Zgjedhor.
3. Paraqitja e ankesës nuk e pengon ose nuk e ndërpret procesin zgjedhor.
4. Për të gjitha ankesat e pranuar vendoset jo më vonë se pesë (5) ditë nga momenti i pranimit të ankesës në Presidencë.

Neni 31

Komisioni i Ankesave

1. Presidenti me vendim e themelon Komisionin e Ankesave për shqyrtimin e ankesave në lidhje me procesin zgjedhor për anëtarë të Këshillit.
2. Komisioni i Ankesave themelohet brenda dhjetë (10) ditëve nga lëshimi i njoftimit publik, me të cilin ftohen organizatat përfaqësuese të komuniteteve dhe kandidatët që kandidojnë në mënyrë individuale ta paraqesin kërkesën për aplikim.
3. Komisioni i Ankesave përbëhet nga së paku tre (3) anëtarë, i cili duhet të përfshijë:
 - 3.1. një përfaqësues nga Kabineti i Presidentit;
 - 3.2. një përfaqësues nga Departamenti, dhe
 - 3.3. një përfaqësues nga Sekretariati.

Neni 32

Shqyrtimi i ankesës nga Komisioni i Ankesave

1. Komisioni i Ankesave brenda pesë (5) ditëve nga pranimi i ankesës në Presidencë e bën shqyrtimin e saj.
2. Komisioni i Ankesave i shqyrton dëshmitë e ofruara në ankesë dhe në bazë të tyre vendos që ankesa të pranohet ose jo.
3. Komisioni i Ankesave mund të kërkojë praninë e dëshmitarëve që të dëshmojnë lidhur me rastin konkret.

Neni 33

Vendimet e Komisionit të Ankesave dhe njoftimi i palëve

1. Komisioni i Ankesave merr vendim me shumicë të votave, pas shqyrtimit të ankesës.
2. Komisioni i Ankesave nëpërmjet sekretarit të Zyrës i njofton palët lidhur me vendimin e marrë.

KAPITULLI IX - EMËRIMI I ANËTARËVE TË KËSHILLIT NGA PRESIDENTI

Neni 34

Emërimi i të nominuarve

1. Presidenti me vendim i emëron anëtarët e Këshillit, duke u bazuar në raportin e sekretarit të Sekretariatit të Këshillit, të përcaktuar në nenin 29 të këtij statuti.
2. Gjatë emërimit të anëtarëve të Këshillit, Presidenti merr parasysh renditjen sipas votave të fituara për secilin kandidat dhe përfaqësimin e barabartë gjinor.

Neni 35

Emërimet në mungesë të përfaqësuesit të komunitetit

1. Në rastet kur nuk ka përfaqësim prej ndonjërit nga komunitet, Presidenti e emëron anëtar në Këshill përfaqësuesin e komunitetit që mungon, sipas kritereve të mëposhtme:
 - 1.1. Të jetë person me reputacion nga radhët e komunitetit përkatës;
 - 1.2. Të jetë mbi tetëmbëdhjetë (18) vjeç;
 - 1.3. Të jetë i regjistruar si shtetas/e i/e Republikës së Kosovës;
 - 1.4. Të mos jetë i dënuar për vepër penale.
2. Personi i përzgjedhur nga komuniteti përkatës, para emërimit anëtar i Këshillit nga Presidenti, duhet t'i plotësojë këto dokumente:
 - 2.1. Deklaratën e cila tregon për reputacionin dhe marrëdhënien e mirë me komunitetin që përfaqëson;
 - 2.2. Deklaratën për mospërfshirjen në aktivitete të prishjes së marrëdhënieve ndëretnike në Republikën e Kosovës;
 - 2.3. Deklaratën për respektimin e Kodit të Mirësjelljes;
 - 2.4. CV-në e kandidatit;
 - 2.5. Kopjen e dokumentit të identifikimit të Republikës së Kosovës;
 - 2.6. Dëshmi nga gjykata se kandidati nuk është i dënuar për vepër penale.

KAPITULLI X - PËRFUNDIMI I MANDATIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT

Neni 36

Përfundimi i mandatit

1. Mandati i anëtarit të Këshillit përfundon me:
 - 1.1. skadimin e kohës së rregullt për të cilën është zgjedhur;
 - 1.2. përfundimin e mandatit para kohës.

Neni 37

Përfundimi i mandatit para kohës

1. Anëtarit të Këshillit i përfundon mandati para skadimit të kohës së rregullt për të cilën është zgjedhur, në rast të:
 - 1.1. dorëheqjes;
 - 1.2. vdekjes;
 - 1.3. humbjes së përhershme të aftësisë së veprimit të konstatuar nga gjykata kompetente;
 - 1.4. sëmundjes apo problemeve të tjera shëndetësore, të cilat e bëjnë të pamundur ushtrimin e funksionit të anëtarit të Këshillit;
 - 1.5. shkarkimit.
2. Përfundimi i mandatit të anëtarit të Këshillit, sipas pikës 1.5. të paragrafit 1 të këtij neni, bëhet në rastet kur:
 - 2.1. dënohet për kryerjen e ndonjë vepre penale me vendim përfundimtar të gjykatës;
 - 2.2. dështon në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi si anëtar i Këshillit;
 - 2.3. dështon të marrë pjesë në tri (3) takime të Këshillit radhazi, pa arsye.
3. Nëse mandati i anëtarit të Këshillit përfundon para kohe, emërimi i ri bëhet në pajtim me Ligjin dhe me këtë statut.
4. Emërimi i ri për zëvendësim e anëtarit të Këshillit bëhet në pajtim me procedurat e këtij statuti dhe anëtari i ri shërben vetëm për kohëzgjatjen e mandatit të mbetur të anëtarit të zëvendësuar.

Neni 38

Zëvendësimi i anëtarëve

Procesi i zëvendësimit të anëtarit që i përfundon mandati para skadimit të kohës së rregullt për të cilën është zgjedhur është i njëjtë me mënyrën e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit, sipas procedurave të përcaktuara në këtë statut.

KAPITULLI XI - BUXHETI I KËSHILLIT

Neni 39

Buxheti

1. Në pajtim me dispozitat përkatëse të ligjit, buxheti vjetor i Këshillit rrjedh nga buxheti vjetor i Zyrës së Presidentit.
2. Buxheti i Këshillit duhet të jetë i mjaftueshëm për të siguruar zbatimin e mandatit kushtetues dhe ligjor, funksionimin e plotë dhe të efektshëm të Këshillit, grupeve të tij punuese dhe Sekretariatit.
3. Zyra e Presidentit, me rastin e përcaktimit të shumës së buxhetit vjetor, duhet të marrë parasysh propozimet e Këshillit.

Neni 40

Kompensimet e anëtarëve

1. Kryesuesi, zëvendëskryesuesit, anëtarët e Këshillit dhe anëtarët e grupeve punuese të Këshillit kanë të drejtë kompensimi për punën e tyre në Këshill dhe rreth angazhimeve për Këshillin.
2. Lartësia e shumës së kompensimit përcaktohet me vendim të miratuar nga Presidenti, sipas propozimit të Sekretariatit.

KAPITULLI XII - DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 41

Rregullorja e Punës e Këshillit

1. Këshilli e miraton Rregulloren e Punës, me të cilën përcaktohen procedurat e brendshme të veprimit për funksionimin e Këshillit.
2. Këshilli e miraton Rregulloren e Punës me dy të tretat (2/3) e anëtarëve të saj.
3. Ndryshimet dhe plotësimet e Rregullores së Punës bëhen me shumicë prej dy të tretave (2/3) të anëtarëve të Këshillit.

Neni 42

Plani i punës

1. Këshilli, në tremujorin e fundit të secilit vit, e miraton Planin vjetor të punës për vitin vijues, me të cilin caktohen objektivat e punës dhe aktivitetet e Këshillit.
2. Në pajtim me nenin 12 (10) të Ligjit, Këshilli ia dërgon Presidentit dhe Kuvendit raportin vjetor të punës për vitin paraprak, deri më 31 mars të vitit vijues.

3. Plani dhe raporti vjetor i punës publikohet në ueb-faqen e Këshillit.

Neni 43

Nxjerrja e akteve

1. Rregullorja e Punës e Këshillit dhe Kodi i Mirësjelljes miratohen brenda periudhës gjashtë (6) mujore nga hyrja në fuqi e këtij statuti.
2. Rregullorja e Punës e Këshillit Konsultativ për Komunitete (25. 7. 2013) dhe Kodi i Mirësjelljes për organizatat e akredituara përfaqësuese të komuniteteve (20. 6. 2013) vazhdojnë të zbatohen deri në miratimin e Rregullores dhe Kodit të përcaktuar në paragrafin një (1) të këtij neni, me kusht që të mos jenë në kundërshtim me këtë statut.

Neni 44

Përkthimi i Statutit

Sekretariati i Këshillit, në bashkëpunim me Departamentin, përkujdesen që ky Statut të përkthehet në të gjitha gjuhët e anëtarëve të Këshillit.

Neni 45

Shfuqizimi

1. Me hyrjen në fuqi të këtij statuti, shfuqizohen:
 - 1.1. Statuti i nxjerrë me Dekretin e Presidentes së Republikës së Kosovë nr. KKK-001 - 2012, i datës 18 prill 2012, dhe
 - 1.2. Neni 30 i Rregullores (P) nr. 02/2016 për strukturën organizative të Presidencës (8. 9. 2016). Neni 21 i këtij statuti përfshihet nga Departamenti në vend të nenit 30 në Rregulloren (P) nr. 02/2016.

Neni 46

Hyrja në fuqi

Ky statut hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas miratimit me dekret nga Presidenti.

Hashim THAÇI

President i Republikës së Kosovës

Prishtinë, 06.12.2017

**Miratuar me dekretin Nr. DNJ-02-2017,
datë 06.12.2017 nga Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi**